



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAMI ORIENTUES PËR TESTIMIN E INFORMUATIZUAR “MËSUES PËR SHQIPËRINË” TË KANDIDATËVE TË ARSIMIT SPECIAL

2020

I. HYRJE

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” në arsimin special është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit të arsimit special. Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MASR ka vendosur për kandidatët që testohen. Ai është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- Dokumente zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve.
- Programe lëndore.
- Aspekte të pedagogjisë dhe të metodologjisë në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi, si dhe të arsimit special në veçanti.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Përmbajtja shkencore e kurrikulës së arsimit special.

II. QËLLIMI I PROGRAMIT

¹Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” në arsimin special është hartuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të tyre.

Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore.
- Rritjen e aftësive profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të arsimit special, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe të komunikimit në punën e tyre në shkollë.
- Rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes.
- Realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve.

III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të arsimit special është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i arsimit special që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij, si për çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, **për secilën fushë prezantohen kompetencat** që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive, **si dhe literatura përkatëse rekomanduese** që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

Gjithashtu, programi përmban edhe rubrikën e strukturës së testit ku përcaktohen përqindjet që zë secila fushë në test si dhe pikët përkatëse.

FUSHA “DOKUMENTE ZYRTARE”

<p align="center">Kompetenca</p> <p>“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”</p>	<p align="center">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe dispozitat normative të këtij sistemi; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASR-së në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Urdhër Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” - Udhëzimi nr.18, datë 20.08.2019 “Për vitin shkollor 2019-2020 në sistemin arsimor parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. - Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. - Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”. - Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”.
<p align="center">FUSHA “PROGRAME LËNDORE”</p>	

Kompetenca “Përshtatja në mënyrë efektive i programeve në lidhje me specifikat e fëmijëve në arsimin special”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arsimit special:</i> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton dhe përshtat programet në lidhje me specifikat e fëmijëve në arsimin special; - përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të fëmijëve në arsimin special; - përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar zhvillimin e aftësive të fëmijëve në arsimin special; - harton programet edukative individuale PEI në përputhje me specifikat e fëmijëve në arsimin special. 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza kurrikulare, 2014. - Kurrikula bërthamë AMU, klasat 6-9, 2014. - Programet aktuale lëndore të arsimit fillor. - Literaturë që ka në fokus sindroma të ndryshme si autizëm, down, prapambetje mendore, çrregullime të sjelljes, hiperaktivitet etj..

FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”	
Kompetenca I “Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme për mësimdhënien në arsimin special”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arsimit special:</i> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar; 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017. - Literaturë që ka në fokus sindroma të

<ul style="list-style-type: none"> - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara; - planifikon një orë mësimore duke u bazuar në programin PEI; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e secilës fushë të zhvillimit të fëmijës. - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për fëmijën; - punon me prindërit për përmirësimin e progresit të fëmijës. 	<p>ndryshme si autizëm, down, prapambetje mendore, çrregullime te sjelljes, hiperaktivitet etj..</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzues dhe materiale mbështetëse që orientojnë planifikimin, organizimin e orës së mësimit dhe vlerësimin në arsimin special.
--	--

FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”

<p style="text-align: center;">Kompetenca</p> <p style="text-align: center;">“Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, fëmijët, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, fëmijët, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Draft Standardet profesionale të mësuesit në arsimin parauniversitar, IZHA, 2016. - Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”

Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”	
Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënie në arsimin special”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit special:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe shpjegon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon kurrikula në arsimin special; - dallon karakteristikat e fëmijëve për secilën fushë të zhvillimit të tyre; - dallon karakteristikat e fëmijëve sipas llojeve të aftësisë së kufizuar; - tregon aktivitetet kryesore që dallojnë fëmijët në arsimin special sipas llojeve të aftësisë së kufizuar; - dallon modelet e ndërhyrjeve të efektshme të fëmijët me aftësi të kufizuar. 	<ul style="list-style-type: none"> - Literaturë që ka në fokus njohuri dhe informacion rreth sindromave të ndryshme si autizëm, down, prapambetjen mendore, çrregullime të sjelljes, hiperaktivitet etj.. - Literaturë që ofron informacion dhe shembuj konkret të punës me fëmijët me sindroma të ndryshme si autizëm, down, prapambetje mendore etj..